



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

19.04.2023

Drejtuar: “AZ Trading” sh.p.k, me NUIS L81515016F, me adresë Tiranë, Njësia Administrative nr.7, Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1, Njësia nr.13.

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-59206-02-15-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje mjete transporti”, me fond limit: 28.130.000 (njëzet e tetë milion e njëqind e tridhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.17, datë 20.02.2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **“AZ Trading” sh.p.k**, me NUIS L81515016F dhe me vlerë të ofruar prej 27.150.000 (njëzet e shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.
2. **“GERARD - A” sh.p.k**, me NUIS L12407005L dhe me vlerë të ofruar prej 18.200.000 (tetëmbëdhjetë milion e dyqind mijë) lekë pa tvsh.
3. **“SPARKLE 32” sh.p.k**, me NUIS L51327014R, dhe me vlerë të ofruar prej 27.850.000 (njëzet e shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “GERARD - A” shpk me NUIS L12407005L.

Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*

b) *për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. pasi O.E në kontratat e ngjashme të ngarkuara në sistem nuk janë të sakta për këto arsye:*

Kontrata Nr.2025/19 dt:05.12.2022 nuk është e shoqëruar me faturë tatimore.

Kontrata Nr.1715/3 dt:15.07.2020 nuk është e shoqëruar me faturë tatimore dhe me vërtetim realizimi.

Kontrata Nr.433/11 dt:12.04.2018 është jashtë afatit të kërkuar në DST, dhe si rrjedhojë O.E nuk përmbush vlerën e kërkuar në DST.

Nuk përmbush pikën 2.3. 2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *2.Operatori ekonomik duhet të deklarojë për secilin mjet llojin e tyre (marka, modeli, viti i prodhimit, numri i identifikimit të tij) të shoqëruar me foto nga të gjitha anët dhe me dokumentacionin përkatës (katalog/skedë teknike/librezë/leje qarkullimi), në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Gjithashtu duhet të deklarohen kilometrat e përshkuara, të shoqëruara me foto të treguesit të kilometrazhit. Për autokullen duhet të deklarohen edhe oret e punës, të shoqëruara me foto të treguesit të oreve të punës, pasi O.E nuk ka paraqitur foto të treguesit të kilometrazhit, për mjetet: kamioncinë dhe dy minifurgona. Gjithashtu mjetin autokullë e disponon me më shumë se 200 orë pune që kërkohet në DST.*

2. “SPARKLE 32” shpk me NUIS L51327014R.

Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. pasi kontrata e ngjashme e paraqitur nga O.E nuk përmbush vlerën e kërkuar në DST.

Nuk përmbush pikën 2.3. 2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se:2. *Operatori ekonomik duhet të deklarojë për secilin mjet llojin e tyre (marka, modeli, viti i prodhimit, numri i identifikimit të tij) të shoqëruar me foto nga të gjitha anët dhe me dokumentacionin përkatës (katalog/skedë teknike/librezë/leje qarkullimi), në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Gjithashtu duhet të deklarohen kilometrat e përshkuara, të shoqëruara me foto të treguesit të kilometrazhit. Për autokullen duhet të deklarohen edhe oret e punës, të shoqëruara me foto të treguesit të orëve të punës, pasi O.E nuk ka paraqitur leje qarkullimi për të gjitha mjetet e kërkuara në DST, por vetëm për Minifurgonin Caddy. Gjithashtu O.E përveç Autokullës, nuk ka paraqitur foto të treguesit të kilometrazhit për të gjitha mjetet e tjera të kërkuara në DST.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **AZ Trading” sh.p.k**, me NUIS L81515016F, me adresë Tiranë, Njësia Administrative nr.7, Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla G&P, Kati 1, Njësia nr.13, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 27.150.000 (njëzet e shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, me adresë në rrugën “5 maji”, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____